



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	17-11-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
JAMSHICK	7023/2023		1/9



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1253/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1253/2023 të datës 05.10.2023 të ankuesit në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.11.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me A.nr.1253/2023, e datës 05.10.2023, e parashtruara nga ankuesi

II.Shfuqizohet Vendimi me numër të protokollit 3853, i datës 18.09.202, të Njesisë së Burimeve Njerëzor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, **anulohet** Konkursi me numër reference RN00012238, për pozitën *Zyrtar Ligjor 1*, i shpallur me datë 09.08.2023, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë rekrutimi.

III.Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, të gjitha këto në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje referuar ankuesi), përmes postes, me datë 04.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 05.10.2023, nën shenjën A.nr.1253/2023, kundër Vendimit më numër të protokollit 3853 të datës

18.09.2023, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbi bazën e pretendimeve së ka plotësuar kriteret e konkursit, mirëpo nuk i është shqyrtuar dokumentacioni i tij në mënyrë meritore dhe të paanshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 11.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa, Këshilli me datë 12.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6401 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me numër të protokollit 3853 të datës 18.09.2023, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Menaxheres së Personelit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Zarfi postar me shifër: R5532214 të datës 04.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.10.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.10.2023; Shkresën e Sekretarit të MBPZHR e datës 03.08.2023; Shtojca Nr.3: Formulari i përshkrimit të punës e datës 03.08.2023; Kopja e konkursit me numër të referencës: RN00012238; Aplikacionin e ankuesit të datës 30.08.2023 ae bashku me dokumentacionin e aplikimit si: Diploma e datës 24.05.1982; Diplomën e datës 17.06.2013 me Nr.1951 me vërtetim të kopjes nga noteri; Diplomën e ankuesit me Nr.436, të datës 19.04.2013 me vërtetim të kopjes nga noteri; Certifikatën e datës 07.07.2004; Referencë e datës 21.11.2022; Vendimin e datës 20.06.2006 lëshuar nga NTJ "EXIMKOS", Kontratën e punës të datës 15.02.2006; Kontratën e punës të datës 15.12.2005; Kontratën e punës të datës 15.06.2005; Letër rekomandim e datës 10.2014; Vërtetim e datës 12.02.2016; Vërtetimin e datës 24.12.2013; Kontratë pune e datës 01.12.2010; Aktin e emërimit të ankuesit i datës 25.04.2023; Vërtetimin e datës 24.08.2023; Referencën e datës 30.08.2023; Kopjen e letërnjoftimit t ankuesit; Listën e aplikantëve; Listën e ngushtë; Vendimin e datës 27.09.2023; Vendimin e datës 05.09.2023 me shifër:3655; Ankesën e ankuesit të datës 14.09.2023; Referencën e datës 03.12.2003; Referencën e datës 21.11.2022; Njoftimin e datës 05.09.2023; E-mailin e datës 13.09.2023 dërguar nga F.M për E.Z.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesav, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 09.08.2023, ka shpallur Konkursin lëvizje brenda kategorisë, me numër të referencës RN0001223, për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1" në Departamentin Ligjor", Klasa "Profesional 3, numri i kërkuar një (1 vend pune), e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi më datë 30.08.2023.

Në fazën e verifikimit paraprak Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më vendimin më numër të protokollit 3655 të datës 05.09.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit më arsyetimin se i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar me nenin 41 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton se me rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale kandidati duhet të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

Ankuesi kundër Vendimit më numër të protokollit 3655 të datës 05.09.2023, parashtron ankesë të brendshme, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes Vendimit më numër të protokollit 3853 të datës 18.09.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke lënë në fuqi Vendimin më numër të protokollit 3655 të datës 05.09.2023.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon së ka plotësuar kriteret e konkursit, mirëpo nuk i është shqyrtuar dokumentacioni i tij në mënyrë meritore dhe të paanshme. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe ankuesit ti mundësohet vazhdimi me procedurat tjera të lëvizjes brenda kategorisë apo të avancimit në një rast tjetër.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtues që ka të bëjë me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e në mbështetje të dispozitave të nenit 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00012238, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë, nga dhe ka vërejtur kundërtënie në mes të vet shkresave të lëndës lidhur me pozitën e shpallur, përkatësisht sipas shkresës së datës 03.08.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është aprovuar procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e punës “**Zyrtar Ligjor**”, ndërsa sipas Konkursit titulli i pozitës së shpallur është “**Zyrtar Ligjor I**”, klasa e pozitës “**Profesional 3**”, kurse si kërkesa të përgjithshme formale janë vendosur:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit nga analizimi i fakteve si me lartë, konstaton së konkursi i shpallur i datës 09.08.2023 me numër të referencës RN00012238, është përcjell më mos përputhje të të dhënave lidhur me klasën e pozitës dhe së kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar sipas konkursit për klasën Profesional 3 janë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.1/8, pasi që lidhur me klasën **Profesional 3**, kërkesat e përgjithshme formale janë të përcaktuara si në vijim: a) **Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve;** c) **Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet,** kurse sipas konkursit është kërkuar: *Se paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Andaj, pas konstatimit si me lartë së akti i shpalljes së konkursit është i përfshire më shkelje esenciale të dispozitave ligjore për Shërbimin Civil, respektivisht shkelje të kriterëve formale të përcaktuara sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet ankimore të ankuesit, ngase, të gjeturat e tjera eventuale nuk do të kishin asnjë relevancë juridike në këtë procedurë, për faktin së me konkursin e shpallur të datës 08.09.2023, janë përcaktuara kritere shtesë lidhur me përvojën e punës jashtë kërkesave ligjore, e të cilat kërkesa kanë pamundësuar konkurrimin apo përzgjedhjen eventuale të kandidatëve të tjerë potencial të cilët nuk e kanë pas një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura,

Siç u tha me sipër, dhe duke qenë se shpallja e Konkursit për lëvizje brenda kategorisë, me numër reference RN00012238, për pozitën “Zyrtar Ligjor 1”, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është përcjell me shkelje ligjore të specifikuar si me lart, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së një procedurë e përcjell me shkelje procedurale konsiderohet si e paligjshme, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vendosi që konkursi me numër të reference RN00012238 të anulohet në tërësi, ndërsa, ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm mbi bazën e të gjeturave si më lartë.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1253/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Arkivit të KPMSHCK-së.